



Pranuar / Dorezuar Pritiljeno/Prodato Received/Delivety	27-01-2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHK	370/2022		1/3



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1195/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari- Kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti- anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1195/2021 të datës 17.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.1195/2021 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Obiliqit, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e një shumë monetare në vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil për ankuesin

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Obiliqit sipas Akt emërimit me numër I/12 të datës 26.02.2014 në vendin e punës "Zyrtar për punë juridike", në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emërgjencë, me datë 26.11.2021 me numër II-31853 ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Obiliqit për kompensimin e një (1) page mesatare në shërbimin civil në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes përkatësisht me rastin e vdekjes së nënës e cila ka vdekur me datë 26.10.2021.

Me datë 14.12.2021 përmes shkresës me numër II/1481 Kryetari i Komunës së Obiliqit e njofton ankuesin se: *“me vendimin e Kuvendit Komunal të Obiliqit nr.I-13 të dt.26.02.2014, ne si institucion bëjmë pagesën e shërbimeve të varrimit për çdo qytetarë të komunës tonë. Andaj edhe për anëtarin e familjes tuaj kemi kryer pagesën për shërbimet e varrimit përmes Bashkësisë Islame-Komuna e Obiliqit ku kemi si dëshmi edhe Faturën me Nr.195 nga Bashkësia Islame. Ju bëjë me dije se edhe pagesa e lartëcekur konsiderohet ndihmë financiare me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes”.*

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 14.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit me datë 17.12.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 6209/2021 me të cilën kërkon që ti njihet kompensimi me rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek organi i punësimit, ndërsa më datë 14.01.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Obiliqit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/16.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 17.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjia e datës 14.12.2021 e Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Kërkesa e ankuesit e datës 26.11.2021; Certifikata e vdekjes V 10458114; Esktrakti nga regjistri qendëror i gjendjes civile E 25708407; Vendimi i Kryetarit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit i datës 26.02.2014; Akt emërimi i ankuesit i datës 26.02.2014; Vërtetimi me nr.78 i datës 21.12.2021; Fatura nga Bashkësia Islame e Kosovës me nr.195; Libri Amëz i të vdekurëve 2021- Nr.195; Fletëlëshimi me Nr.i amzës 1372; Kërkesa e ankuesit e datës 26.11.2021 si dhe përgjigjia në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit të parashtruar me ankesën e datës 17.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka kërkuar që ti njihet e drejta e kompensimit të një shume monetare në vlerën e një (1) page mesatare në shërbim civil me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes konkretisht të nënës së tij, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar pasi që me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafin 2 nën paragrafin 2.4 të është përcaktuar se nëpunësit civil gëzojnë të drejtën e ndihmës institucionale me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes si në vijim: *„2.Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.4. „Ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil”*, si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 33/2010 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil përkatësisht me nenin 22 paragrafin 2 ku përcaktohet se: *„Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare më vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil”*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se në baze të dispozitave të lartpërmendura ankuesit



i takon kompensimit i një (1) page mesatare në shërbim civil me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes në këtë rast Nënës.

Mbi këtë bazë duke i'u referuar shkresave të lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes me numër V 10458114 te datës 12.11.2021 të dorëzuar nga ankuesi, Kolegji ka konstatuar se

gjegjësisht nëna e ankuesit ka ndërruar jetë me datë 26.10.2021, ndërsa bazuar në Vërtetimin me nr.78 të datës 21.12.2021 të lëshuar nga Drejtoria e Administratës së Komunës së Obiliqit, Kolegji ka konstatuar se e ndjera ka jetuar në bashkësi familjare me ankuesin deri në ditën e vdekjes, kështu që duke iu referuar nenin 22 paragrafit të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenit 22 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 33/2010 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimin ankimor i ankuesit për kompensim *me një shumë monetare në vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil* me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, në rastin konkret me rastin e vdekjes së nënës është i bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1195/2021.

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi,
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

